

Jo çdo harresë është demencë

FLETË INFORMACIONI NGA QENDRA SUEDEZE E DEMENCËS

All glömska är inte demens • faktablad på albanska

Kur funksionet e trurit përkeqësohen

Pothuajse çdo gjë që bëjmë, varet nga funksionet e lidhura me të menduarit tonë. Funksione të ndryshme *kognitive* janë aktive kur gërmojmë në kujtesën tonë, mësojmë gjëra të reja ose kërkojmë artikuj në një dyqan. Këto funksione janë jetike për aftësinë tonë për të jetuar një jetë të pavarur.

Dëmtimi kognitiv nënkupton përkeqësimin e dukshëm të një ose më shumë funksioneve kognitive, krahasuar me gjendjen e mëparshme. Kjo mund të manifestohet, për shembull, si harresë ose si vështirësi në gjetjen e rrugës apo në planifikimin dhe kryerjen e aktiviteteve që zakonisht janë të thjeshta.

Është e rëndësishme të hetohet dëmtimi kognitiv, që të mund të jepet trajtim optimal. Megjithatë, shërbimet e kujdesit shëndetësor nuk janë gjithmonë në gjendje të gjejnë një shpjegim të qartë për simptomat, veçanërisht në rastet e lehta.

Dëmtimi kognitiv zakonisht ndahet në tre nëngrupe: hutim i papritur, dobësim i lehtë i aftësive mendore dhe sëmundje kognitive (demencë).

Hutimi i papritur shpesh largohet vetvetiu

Kur simptomat kognitive zhvillohen gjatë një periudhe të shkurtër kohore, zakonisht bëhet fjalë për hutim të papritur. Termat mjekësorë të përdorur janë gjendje hutimi akut ose delirium. Te të moshuarit, kjo shpesh lidhet me sforcimin fizik dhe mendor pas operacionit ose për shkak të dhimbjes. Hutimi i papritur mund të shkaktohet edhe nga kapsllëku, infeksioni dhe efektet anësore të ilaçeve.

Hutimi i papritur mund të trajtohet, ndërsa simptomat zakonisht zhduken, me kusht që gjendja të hetohet dhe shkakut bazë të trajtohet.

MCI nënkupton simptoma të lehta

Shumë persona i drejtohen mjekut nga shqetësimi se nuk funksionojnë më si më parë. Simptomat mund të jenë të paqarta dhe të lehta, megjithëse personi mund ta ketë më të vështirë të përqendrohet, të mbajë mend gjëra ose mund t'i duhet më shumë kohë për të kryer veprime të zakonshme.

Këto janë shenja tipike të *dëmtimit të lehtë kognitiv* ose MCI-së, i cili është akronimi që përdoret shpesh.

Në rastet e MCI-së, dëmtimi kognitiv mund të zbulohet në testet neuropsikologjike. Simptomat mund të ndikojnë në jetën shoqërore ose punën e personit, por ndikimi nuk është aq i madh sa në demencë.



Ka shumë shkaqe të mundshme

MCI mund të ketë shumë shkaqe. Depresioni i patrajtuar, goditja në tru dhe efektet anësore të ilaçeve, janë vetëm disa shembuj. MCI ndonjëherë mund të jetë shenjë e hershme e një çrregullimi kognitiv, siç është sëmundja e Alzheimerit ose demenca vaskulare. Në raste të tilla, simptomat bëhen më të forta dhe më të shumta me kalimin e kohës. Megjithatë, plakja karakterizohet me njëfarë përkeqësimi të funksioneve kognitive, pa qenë shkaktar demenca. Shkalla në të cilën ndodh kjo, ndryshon nga personi në person.

Ankthi, lodhja dhe depresioni, janë të zakonshme për MCI-në dhe mund t'i bëjnë simptomat kognitive më të forta. Ngarkesa e lartë e punës dhe stresi mund të sjellin probleme kognitive te njerëzit në moshë pune, edhe nëse probleme të tilla nuk mund të zbulohen në testet neuropsikologjike.

Kontrolli pasues është i domosdoshëm

Trajtimi i MCI-së kërkon identifikimin e shkakut bazë. Kjo nuk është gjithmonë e mundur. Megjithatë, është e rëndësishme që ofruesit e kujdesit shëndetësor të ndjekin rregullisht pacientët me MCI, pavarësisht nëse dëmtimi kognitiv mund të zbulohet në situata testimi apo ndihet vetëm nga vetë personi.

© Svenskt Demenscentrum

Informacion shtesë dhe materiale informuese në gjuhën shqipe, mund të gjenden në faqen zyrtare të Svenskt Demenscentrum: www.demenscentrum.se/al



Svenskt Demenscentrum

Svenskt Demenscentrum, Sveavägen 155, 113 46 Stockholm, (08) 690 58 00, info@demenscentrum.se

www.demenscentrum.se

All glömska är inte demens

FAKTABLAD FRÅN SVENSKT DEMENSCENTRUM

När hjärnans funktioner sviktar

Nästan allt vi gör är beroende av funktioner kopplade till vårt tänkande. När vi letar i minnet, lär oss nya saker eller söker efter varor i butiken är olika *kognitiva funktioner* aktiva. De har stor betydelse för våra möjligheter att leva ett självständigt liv.

När en eller flera kognitiva funktioner fungerar märkbart sämre än förr talar man om *kognitiv svikt*. Den kan yttra sig som exempelvis glömska, problem med att hitta rätt eller att planera och utföra normalt sett enkla aktiviteter.

Det är viktigt att utreda kognitiv svikt för att kunna behandla den på bästa sätt. Men det är inte alltid vården kan hitta en entydig förklaring till symtomen, det gäller särskilt om de är lindriga.

Kognitiv svikt brukar delas in i tre undergrupper: akut förvirring, lindrig kognitiv funktionsnedsättning och kognitiv sjukdom (demenssjukdom).

Akut förvirring går ofta tillbaka

När kognitiva symtom utvecklas snabbt, under en kort tid, handlar det ofta om akut förvirring eller konfusion som det heter på fackspråk. Hos äldre personer beror det ofta på fysisk och psykisk ansträngning efter en operation eller på grund av smärta. Akut förvirring kan också bero på förstopning, infektioner och läkemedelsbiverkningar.

Akut förvirring kan behandlas och symtomen brukar gå tillbaka, förutsatt att tillståndet utreds och att man kommer till rätta med den bakomliggande orsaken.

MCI förkortning vid lindriga symtom

Många söker sig till vården av oro för att de inte riktigt fungerar som tidigare. Symtomen kan vara diffusa och svaga men personerna upplever ändå tydligt att det har svårare att koncentrera sig och lägga saker på minnet eller att det tar längre tid att utföra olika aktiviteter.

Det här är typiska tecken vid lindrig kognitiv

funktionsnedsättning eller MCI (*Mild cognitive impairment*) som är den ofta använda engelska förkortningen.

Vid MCI kan den kognitiva nedsättningen påvisas i neuropsykologiska tester. Symtomen kan påverka personernas sociala liv eller yrkesarbete men inte i lika hög grad som är fallet vid demens.



Många möjliga orsaker

MCI kan ha många orsaker. Obehandlad depression, stroke och läkemedelsbiverkning är bara några exempel. I vissa fall kan det handla om tidiga tecken på en kognitiv sjukdom, till exempel Alzheimers sjukdom eller vaskulär demens. Då blir symtomen starkare och fler efterhand. Men åldrandet innebär att kognitiva funktioner kan försämrans något utan att det behöver bero på demens. I vilken grad det sker varierar från person till person.

Oro, trötthet och nedstämdhet är vanligt vid MCI och kan förstärka kognitiva symtom. Hög arbetsbelastning och stress gör att personer i yrkesverksam ålder kan uppleva sig ha kognitiva problem utan att det kan påvisas i neuropsykologiska tester.

Uppföljning är A och O

Behandling av MCI förutsätter att den bakomliggande orsaken är känd, något som inte alltid är fallet. Det är ändå viktigt att vården regelbundet följer upp den som är drabbad, oavsett om den kognitiva funktionsnedsättningen går att avläsa i testsituationer eller endast är självupplevd.

2025 • Svenskt Demenscentrum ©

Fler faktablad på olika språk kan skrivas ut från Svenskt Demenscentrums webbplats:
www.demenscentrum.se/Faktablad



Svenskt Demenscentrum

Svenskt Demenscentrum, Sveavägen 155, 113 46 Stockholm, 08 - 690 58 00, info@demenscentrum.se

www.demenscentrum.se